# DËSHMI ARKIVI

**A-421814**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Keqpërdorimi i imazhit të këngëtarit Ilir Shaqiri, për të mashtruar qytetarët me probleme me prostatitin |
| ADRESA | `https://kallxo.com/krypometer/keqperdorimi-i-imazhit-te-kengetarit-ilir-shaqiri-per-te-mashtruar-qytetaret-me-probleme-me-prostatitin/` |
| BURIMI | kallxo.com |
| GJENDJA | unreachable |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 03:13:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 19:20:12 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `26f257f01e682f4875ef6eafc3946a8e3b06635dcf234038d3dea100f62a47f5` |
| TEKSTI | `ab0d373777f411e25f1b84933e3cea3323a621466be2001bac60f13dacfb4e3d` |
| PAMJA | `640d52b136c4772c32a691a6b5b5f5cf60e4db301b01cdec1b4c4eb839fd3065` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `975354027f867d62c28ecc51754f47771ac2d9155c9b8437b5c3e3645b9e7034` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c73b9db3b820e04b50f750a03f22fa10ff4921dd00c9878ab3e6c4922c61ec25` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/975354027f867d62c28ecc51754f47771ac2d9155c9b8437b5c3e3645b9e7034`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

notification icon Kliko PO dhe abonohu për lajmet dhe hulumtimet kryesore të ditës

JO PO





Redaktuar nga Visar Prebreza, shkruar nga Luljeta Beselica

31.8.2026 - 21:20




# Keqpërdorimi i imazhit të këngëtarit Ilir Shaqiri, për të mashtruar qytetarët me probleme me prostatitin



Redaktuar nga Visar Prebreza, shkruar nga Luljeta Beselica

31.8.2026 - 21:20

**Deklarata**



Prostatiti mund të çojë në impotencë dhe kancer të prostatës! Por ai mund të shërohet edhe në kushte shtëpie. Mos prisni pasojat!

faqet në Facebook

**Vlerësimi**



**Krejt**

Është krijuar një video në të cilin pretendohet se këngëtari Ilir Shaqiri po tregon se si është shëruar nga sëmundja e prostatitit. Videoja është krijuar përmes Inteligjencës Artificiale duke përdorur video të publikuara nëpër mediat në Kosovë. I kontaktuar nga Krypometër, Ilir Shaqiri ka thënë se videoja është e rreme, pasi asnjëherë nuk e ka bërë një deklaratë të tillë. Në këtë video keqpërdoret imazhi i Radio Televizionit të Kosovës dhe gazetares, Alketa Gashi Fazliu. Për Krypometër, Gashi Fazilu ka thënë se videoja është e rreme. Urologu Rinor Dervishi ka thënë se pacientët trajtohen në bazë të protokolleve të cilat janë të bazuara në udhëzimet e fundit nga institucionet shëndetësore.



**Artikulli**

Më 26.08.2026 faqja në Facebook Paula Mary Gabrielle (arkiva, arkiva), ka publikuar një video të pretenduar të lajmeve në RTK, personazhi i së cilës është këngëtari i muzikës popullore, Ilir Shaqiri.

"Prostatiti mund të çojë në impotencë dhe kancer të prostatës! Por ai mund të shërohet edhe në kushte shtëpie. Mos prisni pasojat!"- shkruan në përshkrim të videos.



"Urgjentisht nga Prishtina në emisionin të Televizionit Kombëtar të Kosovës u dëgjua një deklaratë që tronditi të gjithë vendin. Ilir Shakiri krenaria e Kosovës, sulmoi hapur farmaceutet, duke i quajtur vrasës me mantile të bardha, arsyeja e cila sipas tij i riktheu organizmin, e çliroi nga prostatiti kronik ndaloi impotencën dhe ndaloi plotësisht kancerin e prostatës….."- thuhet ndër tjerash në këtë video.



Pastaj si pjesë e materialit është edhe një deklaratë e pretenduar e Shaqirit.

"3 vite jetova në ferr, prostatiti më shqeu, urinimi natën çdo orë….nuk mund të bëja asgjë pa qetësues…."- pretendohet se po thot Shaqiri.



Krypometër fillimisht ka testuar videon në HIVE, program i cili ka vërtetuar se videoja është e realizuar me Inteligjencë Artificiale (arkiva).



Krypometër ka kërkuar edhe një koment nga vet këngëtari Shaqiri, i cili e ka demantuar një gjë të tillë.



"Kjo është një mashtrim i madh, është video me AI."- ka thënë Shaqiri.



Në këtë video shfaqet gazetarja dhe moderatorja e lajmeve në RTK, Alketa Gashi Fazliu, të cilës Krypometër i ka kërkuar një koment lidhur me këtë pretendim.



Ajo ka thënë se është keqpërdorim i imazhit dhe se asnjëherë nuk e ka dhënë një lajm të tillë.



Në këtë histori paraqitet edhe urologu Ajet Xhafa duke folur për dy përbërës të thjeshtë që shërojnë prostatën por që nuk bëhet publike një gjë e tillë e pretenduar.

Krypometër ka gjetur videon reale të Xhafës i cili ka qenë i ftuar në Televizionin T7, i cili kishte folur për kancerin e prostatës, por nuk kishte përmendur ndonjë përbërës për shërimin e prostatës.

**Prostatiti**

Urologu Rinor Dervishi ka thënë se pacientët trajtohen në bazë të protokolleve të cilat janë të bazuara në udhëzimet e fundit nga institucionet shëndetësore.

Ai ka thënë se kur prostata ka infeksion, ajo mund të trajtohet me ilaçe, mirëpo kur infeksioni rritet atëherë duhet trajtim tjetër.

“Prostata nëse është e infektuar, por jo e rritur, mund të trajtohet me ilaçe. Në momentin që rritet dhe bën pengesa në urinim, shërimi i vetëm mbetet intervenimi, ku janë disa metoda prej më pak invazive në ato me operacion të hapur.”- ka thënë urologu Rinor Dervishi.

Krypometër ka kërkuar edhe një koment nga specialisti i farmacisë klinike, Astrit Haxhijaha për kritikat e pretenduara në këtë video.

“Ne nuk kemi asnjë arsye të fshehim barna që shërojnë sëmundje apo të rekomandojmë barna që nuk janë të përshtatshme për sëmundje të ndryshme. Detyra e farmacistit është të sigurojë që barnat të përdoren në mënyrë të sigurtë, efektive, bazuar në prova shkencore.”- ka thënë Haxhijaha.

Krypometër ka kontaktuar me urologun Avni Fetahu, i cili ka thënë se trajtimi i sëmundjes së prostatës bëhet bazuar në protokolet shëndetësore, të cilat parashohin edhe barnat e aprovuara e që janë në shitje nëpër barnatore.

Sipas Fetahut, ilaçet që i përshkruajnë për sëmundjet e prostatës janë të licencuara dhe kanë Autorizim për Marketing nga Agjensioni Kosovar për Produkte Mjekësore (AKPPM) si parashihet në Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Këngëtari Ilir Shaqiri gjatë karrierës së tij muzikore i ka kushtuar shumë këngë luftës së Kosovës për liri e pavarësi, si dhe shumë personave që dhanë jetën për këtë kauzë.

Në vitin 2007, Shaqiri e kishte realizuar një këngë kushtuar Pavarësisë së Kosovës e cila ishte kthyer në simbol në ditën e shpalljes së pavarësisë, më 17.02.2008.

Shaqiri ka realizuar këngë edhe për Komandantin Legjendar të UÇK, Adem Jashari dhe disa patriotë të tjerë.

Verifikimi i fakteve


- Facebook Share
- Shpërndaje
- Twitter Share


**Të Fundit**

## Punime në rrjet, KEDS tregon se ku do të ketë ndërprerje të rrymës të hënën

KEDS
06.9.2026

## Gjendet pa shenja jete një 62- vjeçar në Mitrovicë

avni zahiti

## Ferizaj, 7-vjeçari goditet nga vetura, drejtuesi i automjetit largohet nga vendi i ngjarjes

aksident me të lënduar

## Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një policit të Kosovës

Arrestimi

**Kryesore**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka
06.9.2026

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një polici të Kosovës

Arrestimi

**Të ngjashme**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Presidenti ukrainas pret emisarët amerikanë që u takuan me Putinin në Moskë

lufta në Ukrainë

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### Shkodër, arrestohet i dyshuari për disa raste të vjedhjeve

lende narkotike

#### Rreth temës

### Satelitët e Kremlinit: Portali me bazë në Krime dezinformon rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese për tokat në Graçanicë

FACT-CHECK

### BIRN dhe Internews Kosova publikuan raportin "Hartëzimi i dezinformatave" rreth narrativave ruse dhe serbe në media dhe rrjete sociale

Albulena Haxhiu

**Kreshnik Gashi tregon pse kandidatët për kryetar të Prishtinës nuk guxuan të vijnë në Debat Përnime (VIDEO)**

debat pernime
ilustrim: Besnik Krivanjeva/Kallxo.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.